

# KONTRATË PËR KRIJIMIN E PLANIT TË PENSIONIT PROFESIONAL NË FONDIN E PENSIONIT VULLNETAR ALBSIG

Kontratë e lidhur sot, më datë \_\_\_/\_\_\_/20\_\_\_, në Tiranë nga dhe ndërmjet palëve kontraktuese si më poshtë:

**ALBSIG INVEST SHA** - Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive, me NUIS/NIPT L92208025J, me seli në adresën: Rruga e Barrikadave, Albsig HQ,1001, Tiranë, Shqipëri, licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) me Vendimin nr. 210, datë 22/11/2019, përfaqësuar nga z. Elton Korbi, Administrator i Përgjithshëm, me nr. dokumenti identifikimi I30919045R (këtu e më poshtë “Shoqëria Administruese”).

dhe;

## **PUNËDHËNËSI:**

\_\_\_\_\_, i regjistruar me NUIS/NIPT \_\_\_\_\_, me seli në adresën \_\_\_\_\_, përfaqësuar nga Z./Znj. \_\_\_\_\_, Administrator, me nr. dokumenti identifikimi \_\_\_\_\_ (këtu e më poshtë “Punëdhënësi”). \_\_\_\_\_, si punëdhënësi do të anëtarësojë punëmarrësit e tij në Fondin e Pensioneve Vullnetare “Albsig”.

## **Shoqëria PUNËDHËNËSE**

përfaqësuar nga:

\_\_\_\_\_  
(Emër, Mbiemër, Firmë, Vulë nëse ka)

## **ALBSIG INVEST SHA**

Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive përfaqësuar nga Administratori i Përgjithshëm:

\_\_\_\_\_  
(Emër, Mbiemër, Firmë, Vulë)



## NENI 1 - OBJEKTI DHE BAZA LIGJORE

- Objekti i kësaj kontrate është rregullimi i marrëdhënieve midis Punëdhënësit dhe Shoqërisë Administruese, me qëllim krijimin nga Punëdhënësi i një plani pensioni profesional për Punëmarrësit e tij të cilët do të anëtarësohen në Fondin e Pensionit Vullnetar Albsig ("Fondi").
- Kjo kontratë mbështetet në nenet 4, pikat d) dhe rr) dhe 6 të ligjit nr.10197/2009 "Për Fondet e Pensioneve Vullnetare" ("Ligji"), rregulloren e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare nr.2/2011 "Për përmbajtjen e kontratës dhe të prospektit të fondit të pensionit", si dhe prospektin e aktet e tjera të brendshme të Shoqërisë Administruese.

## NENI 2 - ANËTARËSIMI

- Punëdhënësi merr përsipër të paguajë kontribute në Fond në emër dhe në favor të Punëmarrësve me të cilët ka lidhur kontratë pune, sipas listës dhe shumës individuale, bashkëlidhur kontratës.
- Punëdhënësi duhet të informojë Punëmarrësit lidhur me planin e pensionit profesional që ka lidhur nëpërmjet kësaj kontrate. Punëmarrësi vendos se në çfarë niveli do përshatë kontributin e tij personal me kontributin e Punëdhënësit.
- Shoqëria administruese, brenda 20 (njëzet) ditëve pas nënshkrimit të Kontratës me Punëdhënësin lidh kontratën individuale të anëtarësimit në këtë plan me secilin prej Punëmarrësve të tij, në të cilën përcaktohet masa e kontributit që do të paguajë Punëdhënësi dhe Punëmarrësi sipas formatit të kontratës individuale të anëtarësimit në Fond.

## NENI 3 - PAGESA E KONTRIBUTEVE

- Punëdhënësi kryen pagesën mujore të kontributeve për pension vullnetar, përfshirë edhe kontributet personale të mbajtura nga paga e Punëmarrësve në numrin e llogarinë së Fondit IBAN AL76 2061 1004 0000 1003 2114 7100, pranë Bankës Tirana Sh.a, e cila do të kryejë funksionin e Depozitarit të Fondit të Pensionit Vullnetar në përputhje me përcaktimet e ligjit, jo më vonë se dita e dhjetë e muajit pasardhës.
- Punëdhënësi çdo muaj dërgon pranë Shoqërisë Administruese sipas një formati të përcaktuar nga kjo e fundit listë pagesën e punonjësve duke specifikuar kontributin e paguar nga Punëmarrësi dhe kontributin e mbajtur nga paga e Punëdhënësit. Punëdhënësi dhe Shoqëria Administruese nënshkruajnë një Marrëveshje për të Dhënat Personale.
- Punëdhënësi do të informojë Shoqërinë Administruese:
  - në lidhje me Anëtarët e rinj për të cilët do të paguaj kontribute;
  - në lidhje me Anëtarët që ndërpresin marrëdhënien e punës;
  - në rastin e vdekje të Anëtarit në planin e pensionit profesional.
- Punëdhënësi është përgjegjës ndaj Punëmarrësve për mos pagimin e kontributeve të parashikuara në këtë kontratë.
- Në rast se Punëdhënësi apo Punëmarrësi do të ndryshojnë shumën e kontributit, Punëdhënësi duhet të njoftojë me shkrim Shoqërinë Administruese dhe kjo do të reflektohet në mënyrë automatike në kontratën individuale me punëmarrësin.
- Punëmarrësi nuk mund t'i përfitojë kontributet e paguara nga Punëdhënësi nëse ndërpret marrëdhënien e punës përpara 2 (dy) viteve nga pagesa e parë e plotë e kontributeve nga Punëdhënësi.
- Nëse Punëmarrësi ndërpret marrëdhënien e punës brenda periudhës 2 (dy) vjeçare, Shoqëria Administruese do të kthejë Punëdhënësit kontributet e derdhura së bashku me kthimin nga investimi, bazuar në një njoftim me shkrim të Punëdhënësit. Shoqëria Administruese nuk do aplikojë penalitet mbi shumën e kthyer Punëdhënësit. Punëdhënësit i ngarkohen kosto dhe komisione ndërmjet bankave.
- Kur Punëdhënësi ndërpret marrëdhënien e punës me Punëmarrësin, në mënyrë të njëanshme, pa shkaqe të arsyeshme dhe jo për shkaqe të lidhura me Punëmarrësin përpara periudhës së përcaktuar në pikën 6 të këtij neni, kontributet e paguara nga Punëdhënësi do t'i transferohen Punëmarrësit.
- Kur Punëmarrësi është ai që ndërpret marrëdhënien e punës me Punëdhënësin ai mund të mbetet anëtar në fond, apo të transferojë asetet e tij në një fond tjetër në përputhje me dispozitat ligjore dhe me procedurat e Shoqërisë Administruese. Në këtë rast Punëdhënësi ndërpret kontributet për llogari të Punëmarrësit.

## NENI 4 - DEPOZITARI

- Shoqëria Administruese ka lidhur kontratë me Bankën Tirana Sh.a, regjistruar si person juridik shqiptar me Vendimin Nr.12718, datë 03.11.1995 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, NIPT J61924008V, me seli në Tiranë në adresën Rr. "Ibrahim Rugova", e cila sipas ligjit do të jetë Depozitari për asetet e Fondit.
- Depozitari në bazë të Vendimit Nr.23, datë 24.03.2010 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, është licencuar për të ofruar shërbime kujdestarie, depozitimi dhe të besimit, si dhe është miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për të ofruar shërbime depozitimi për asetet e fondit të pensionit dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive me vendimin Nr.2, datë 06.06.2019.
- Depozitari do të jetë përgjegjës për ruajtjen e Aseteve në Fond. Depozitari kontrollon administrimin e aseteve të Fondit nga Shoqëria Administruese, në përputhje me dispozitat e kontratës, prospektit si dhe të legjislacionit në fuqi.
- Depozitari është një entitet tërësisht i pavarur nga Shoqëria Administruese, dhe çdo palë tjetër të lidhur me të, i cili siguron që të gjitha të ardhurat e fondit të pensionit do të shpërndahen në përputhje me Ligjin dhe kontratën.

## NENI 5 - PAGESA E PËRFITIMEVE

- Anëtar i fondit të pensionit, sipas zgjedhjes, ka të drejtë të marrë pagesën e menjëhershme të vlerës neto të aseteve në llogarinë e vet ose pagesat periodike, në formë pensioni, që i përgjigjen kësaj vlere:
- 5 (pesë) vjet përpara se të mbushë moshën e pensionit, të parashikuar me Ligj për sistemin e pensionit të detyrueshëm, që zbatohet për atë Anëtar;
  - kur bëhet i paaftë për punë në mënyrë të përhershme dhe që vërtetohet, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

## NENI 6 - TËRHEQJA E PARAKOHSHME

Punëdhënësi mund të vendos të ndërpres planin profesional kur të paktën 3 (tre) muaj përpara, ka informuar me shkrim për këtë vendim Punëmarrësit, Shoqërinë Administruese dhe Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare.

## NENI 7 - DETYRIMI PËR INFORMIM

- Anëtar i Fondit njihet në çdo kohë me gjendjen e llogarisë së tij. Shoqëria Administruese, të paktën një herë në vit, duhet të njoftojë në mënyrë elektronike Punëdhënësin për gjendjen e mjeteve.
- Shoqëria Administruese duhet të informojë Anëtarët në Fond dhe Punëdhënësin për ndryshimet në ligj, rregulloret dhe tarifrat e Fondit.

## NENI 8 - TARIFAT E SHOQËRISË ADMINISTRUERE

- Shoqëria Administruese do të aplikojë tarifrat e mëposhtme:
  - Tarifa e administrimit të Fondit do të jetë 2.5% (dy pikë pesë përqind) në vit e vlerës neto të aseteve të Fondit. Vlera neto e aseteve përbëhet nga vlera e përgjithshme e aseteve e zvogëluar nga zbritja e detyrimeve dhe tarifave deri në datën e vlerësimit.
  - Tarifa e administrimit të Fondit do t'i ngarkohet aseteve të Fondit në fund të çdo dite, dhe do të mbahet në fund të çdo muaji si shumë e vlerës ditore për atë muaj.
  - Në rastin e transferimit të aseteve në një Fond tjetër të menaxhuar nga një Shoqëri tjetër Administruese, tarifa që do të aplikohet do të jetë 0.5% (zero pikë pesë përqind) e shumës së transferuar.
- Në rastin e tërheqjes së parakohshme:
  - 2% (dy përqind), për çdo tërheqje të parakohshme të kryer pas 20 vitesh nga data e kontributit të parë.
  - 5% (pesë përqind), për çdo tërheqje të parakohshme kryer në periudhën kohore që fillon pas 10 vitesh nga data e kontributit të parë deri në 20 vjet nga data e kontributit të parë, përfshirë edhe vitin e 20-të;
  - 10% (dhjetë përqind), për çdo tërheqje të parakohshme të kryer në periudhën kohore që fillon pas 5 vitesh nga data e kontributit të parë deri në 10 vjet nga data e kontributit të parë, përfshirë edhe vitin e 10-të;
  - 15% (pesëmbëdhjetë përqind), për çdo tërheqje të parakohshme të kryer në periudhën kohore deri në 5 vjet nga data e kontributit të parë, përfshirë edhe vitin e 5-të;
- Çdo ndryshim i tarifave që do të aplikohen nga Shoqëria Administruese, do t'u njoftohet Anëtarëve në Fond të paktën 12 (dymbëdhjetë) muaj përpara se ato të hyjnë në fuqi.

## NENI 9 - KOHËZGJATJA E KONTRATËS

Kohëzgjatja e kontratës do të jetë e pacaktuar. Kjo kontratë do të sjellë pasojë ligjore vetëm pasi të jetë kryer pagesa e parë e kontributit.

## NENI 10 - ZGJIDHJA E KONTRATËS DHE E MOSMARRËVESHJEVE

- Pala që do të zgjidhë kontratën duhet të njoftojë me shkrim palën tjetër të paktën 3 (tre) muaj nga data e zgjidhjes së kontratës.
- Çdo mosmarrëveshje mes palëve të kësaj kontrate do të zgjidhet me mirëkuptim, në të kundërt kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të jetë Gjykata e Shkallës së Parë, Tiranë.

## NENI 11 - DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

- Ndryshimet dhe shtesat në kontratë do të bëhen me mirëkuptim të palëve si dhe do të marrin miratimin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në rastet që kërkohet nga Ligji.
- Kjo kontratë hartohet në gjuhën shqipe në numër kopje origjinale, nga një për secilën palë.
- Kjo kontratë hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët.

